

WITH FUNDING FROM  
AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION



# DOKUMENT ORIENTUES PËR PËRFSHIRJEN DHE MOSDISKRIMINIM E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËRMES AKSESUESHMËRISË



Version në gjuhë të thjeshtuar (easy-read)

Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

RR. "Bogdani" , Nr1, Tiranë

Tel/Fax:+3554269426

[www.info@adrf.al](http://www.info@adrf.al)

E-mail: [info@adrf.al](mailto:info@adrf.al)

Disa nga figurat e këtij materiali janë prodhuar nga "Inspired Services Publishing Ltd"

Ky material është prodhuar në kuadër të Projektit "Shtrirja e Shërbimeve të Ndihmës Ligjore Falas për Gratë dhe Burrat në Shqipëri", që zbatohet nga UNDP në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë me mbështetjen financiare të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

Opinionet e shprehura në këtë material nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP, Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe as të partnerëve kombëtarë.

## ÇFARË KA NË KËTË GUIDË?

<b>1</b>	Hyrje .....	<b>4</b>
<b>2</b>	Qëllimi.....	<b>4</b>
<b>3</b>	Situata .....	<b>5</b>
<b>4</b>	Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (KNDPAK)....	<b>6</b>
<b>5</b>	Zbatimi i detyrimeve të Konventës.....	<b>10</b>
<b>6</b>	Konkluzione/ Rekomandime .....	<b>11</b>

# 1

## HYRJE



Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH, 2011) personat me aftësi të kufizuara përbëjnë 15 përqind të popullsisë në botë, më shumë se një miliardë persona.



Ky dokument trajton çështjet e aksesueshmërisë në kontekstin e Shqipërisë.

# 2

## QËLLIMI

Dokumenti paraqet kuadrin ligjor dhe politik të miratuar nga shteti Shqiptar për Aksesueshmërinë.

Dokumenti fokusohet në pyetjet:



(1) Cilat janë detyrimet e qeverisë shqiptare sipas nenit 9, “Aksesueshmëria”, i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara?



(2) Si po zbatohen këto detyrime nga qeveria shqiptare?

### 3

#### SITUATA



Mungesa e aksesueshmërisë në ambiente, në transport, në informacion dhe komunikim, ka shkaktuar izolim dhe mënjanim të personave me aftësi të kufizuara.



Shoqëria civile, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokati i Popullit, kanë reaguar me vendime dhe rekomandime ndaj diskriminimit dhe mungesës së aksesit për personat me aftësi të kufizuara.

# 4

## KONVENTA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara i kushton vëmendje të vecantë aksesit në mjedisin fizik, aksesit në informacion dhe komunikim.

Aksesueshmëria është një nga tetë parimet e KDPAK.

Aksesueshmëria është parashikuar në mënyrë të detajuar në nenin 9, “Aksesueshmëria”.

Ideja kryesore e konventës është ajo e “mos- rregullimit” të personave me aftësi të kufizuara por e rregullimit të shoqërisë.

Neni 9, i Konventës, “Aksesueshmëria” vendos për Shtetet “detyrimin për të eliminuar pengesat në objektet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në shërbimet e tjera publike, në zonat urbane dhe zonat rurale.


Bazuar në nenin 9 të Konventës detyrimet e qeverisë shqiptare janë:

1

**Të marrë masa të përshtatshme për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuara akses, në kushte të barabarta me të tjerët:**



në mjedisin fizik



në transport



në informacion dhe komunikim

---



në teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit

---



në shërbime të tjera të hapura,  
të ofruara për publikun,  
në zonat urbane dhe në ato rurale.

---

**2** Shteti duhet të kryejë një analizë të situatës për të identifikuar pengesat




3

**Të garantojë akses në mënyrë të vecantë në ndërtesa, rrugë, transport dhe objekte të tjera brenda dhe jashtë, përfshirë shkolla, shtëpi, objektet mjekësore dhe vendet e punës;**



4

**Të hartojë, aprovojë dhe monitorojë zbatimin e standardeve minimale dhe udhëzuesve për aksesueshmërinë;**



5

**Të garantojë që subjektet private që ofrojnë lehtësira dhe shërbime të hapura për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesit për personat me aftësi të kufizuara;**





## 6

### Të sigurojë trajnime për palët e interesuara për çështjet e aksesueshmërisë



Easy read



Large print



BSL



Braille



Email or SMS text




Other communication support

Ndërtesat dhe vendet e tjera të hapura për publikun duhet të kenë sinjalistikë në Braille dhe në forma të lexueshme dhe të kuptueshme lehtë, përfshirë udhëzues, lexues dhe përkthyes profesionistë të gjuhës së shenjave, për të lehtësuar aksesin.



Shteti duhet të promovojë hartimin, prodhimin dhe shpërndarjen e teknologjive dhe sistemeve të informacionit dhe komunikimit të arritshme në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të arritshme me kosto minimale.




Shteti duhet të miratojë një kornizë të përshtatshme ligjore.



Shteti duhet të miratojë një kornizë kohore për realizimin e detyrimeve të saj sipas Konventës.



Shteti duhet të përcaktojë qartë detyrat e autoriteteve të ndryshme.



Shteti duhet të përshkruajë mekanizma efektivë të monitorimit për të siguruar aksesin dhe monitorimin e sanksioneve.

## 5

### REALIZIMI NGA QEVERIA SHQIPTARE I DETYRIMEVE TË PARASHIKUARA NE KNDPAK

Shteti ka ndërrmarë hapa për të plotësuar dhe përmirësuar kornizën ligjore dhe të politikave që rregullojnë aksesueshmërinë në Shqipëri, në përmbushje të kërkesave sipas Konventës.

Është aprovuar Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara

Ligji rregullon aksesueshmërinë në të gjitha dimensionet e saj.

“Aksesueshmëria” sipas ligjit nënkupton shmangien e pengesave nga të gjitha llojet.

Pengesat kanë kuptimin e mëposhtëm:

- pengesat sociale, në veçanti qëndrimet, stereotipet.
- pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim të përjetuara nga personat me dëmtime shqisore, veçanërisht ato me dëmtim të shikimit dhe dëgjimit, ata për të cilët

komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur, për personat që kërkojnë forma të thjeshta vetëm për leximpër të komunikuar.

- pengesat në infrastrukturë, përfshirë ato në hapësira dhe shërbime publike.
- pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politikë.

Masat për heqjen e barrierave mjedisore dhe infrastrukturore në shërbimin publik janë parashikuar në vendimin që ka dalë për zbatim të ligjit në Dhjetor 2015.

## 6

### KONKLUZIONE/REKOMANDIME

Korniza ligjore dhe politike e miratuar pas vitit 2012 është në përputhje me kërkesat e Konventës në lidhje me aksesueshmërinë.



Për të qenë e suksesshme, qeveria duhet të forcojë mekanizmat e monitorimit.



Rekomandohet ndërmarrja e një fushate gjithëpërfshirëse që ky legjislacion të njihet si nga institucionet ashtu edhe nga vetë komuniteti.



Duhet të realizohen trajnime dhe aftësim i punonjësve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit mbi aksesueshmërinë.

---



Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara të përfshihet gjatë marrjes së masave për garantimin e aksesueshmërisë.

---



Caktimi i buxheteve për garantimin ose përmirësimin e aksesueshmërisë mbetet priorityet për realizimin e saj.

